



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

KURRIKULA E BARUAR NË KOMPETENCA

Lënda: TIK

Shkalla: II

Klasa: V

Tiranë, 2018



IZHA
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Përmbajtja e Programi

I. Hyrje	3
II. Korniza konceptuale e programit.....	3
1. Qëllimet e arsimit parauniversitar	6
2. Qëllimi i programit të fushës “Teknologji dhe TIK”	7
2.1 Qëllimi i fushës	7
3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës.....	8
4. Lidhja e TIK-ut me fushat e tjera kurrikulare	12
5. Kompetencat që formohen përmes tematikave	14
6. Koha mësimore për secilën klasë.....	17
6.1 Përmbajtja e shkallës së dytë.....	17
7. SHKALLA E DYTË.....	19
7.1 Tematika : Bota e kompjuterit	19
7.2 Tematika: Përpunimi digjital i të dhënave	21
7.3 Tematika: Kreativiteti dhe Programimi	24
7.4 Tematika: Kërkimi në web/internet	26
7.5 Tematika: Siguria në internet dhe siguria e të punuarit në kompjuter	28
8. Udhëzime metodologjike.....	30
9. Udhëzime për vlerësimin	31
10. Materiale dhe burime mësimore	37
Tabelat dhe digramat	
Diagrama 1 : Korniza konceptuale e programit.....	5
Diagrama 2: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së TIK-ut për shkallën e dytë.....	10
Diagrama 3: Lidhja ndërmjet TIK-ut dhe fushave të tjera.....	13
Diagrama 4: Kompetencat e fushës dhe tematikat e fushës.	14
Tabela 1: Kompetencat e fushës dhe përshkrimi i tyre	15
Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë	17

I. Hyrje

Në kohët e sotme teknologjia dhe TIK-u janë kthyer në një mënyrë jetese me të cilën fëmijët janë të tërhequr. Për t'iu përshtatur sa më mirë ndryshimeve të kohës, është i nevojshëm integrimi i TIK-ut në ciklin fillor, i cili ndikon në zhvillimin e kompetencës digjitale tek të gjithë nxënësit. Fëmijët e sotëm fillojnë të përdorin mjetet digjitale në një moshë shumë të re, ndaj shkolla duhet t'u përgjigjet nevojave të nxënësit.

Arsimi teknologjik është një komponent thelbësor i kurrikulës. Në një botë ku ndeshesh me shumë lloje teknologjish, të cilat janë pjesë e jetës së përditshme për të gjithë njerëzit, nxënësit duhet të pajisen me aftësi për t'u përballur me to me vetëbesim. Është po aq e rëndësishme që nxënësit të vlerësojnë dhe të kuptojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Nxënësit e moshës digjitale vijnë në shkollë me njohuri, gjykime, opinione dhe pyetje të marra nga burime të pafundme digjitale të informacionit, të cilat mësuesi duhet t'i konsiderojë si pjesë të kurrikulës në tërësinë e saj.

TIK-u dhe teknologjia janë një formë e veçantë e veprimtarisë krijuese, ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre duke përdorur materialet, inputet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre.

II. Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga: Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë:

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës së teknologjisë dhe TIK-ut në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriterëve të vlerësimit në periudha të caktuara kohore.
- **hartuesit të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.**


Programi i TIK-ut ka në thelb të tij krijimin e kushteve për ndërtimin e kompetencave të fushës/lëndës si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet fushës së teknologjisë dhe TIK-ut është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e tij në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e TIK-ut me fushat e tjera, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Programi përmban 5 tematika, të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqitet edhe koha mësimore për secilën tematikë, që ndryshon nga klasa në klasë.

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Në këtë program, vlerësimi i nxënësve është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënit.

Programi i TIK-ut, nga pikëpamja e organizimit të përmbajtjes, paraqitet në diagramin e mëposhtëm:

Diagrama 1 : Korniza konceptuale e programit



1 Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes.
- përdorin teknologjitë e reja.

2 Qëllimi i programit të fushës “Teknologji dhe Tik”

2.1 Qëllimi i fushës

- Të kontribuojë në një edukim të balancuar duke iu dhënë nxënësve një përvojë të gjerë dhe sfiduese, që do t’u krijojë mundësi atyre të fitojnë një grup njohurish, aftësish njohëse e përpunuese dhe kompetenca të thjeshta, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesëmarrës në një botë teknologjike.
- T’u krijojë mundësi nxënësve t’i integrojnë këto njohuri dhe shkathtësi/shprehi, së bashku me cilësitë për hulumtim dhe mendim reflektiv, për gjetjen e zgjidhjeve me vëmendjen e duhur ndaj çështjeve të shëndetit dhe sigurisë.
- Të lehtësojë zhvillimin e një sërë aftësive të komunikimit, që do t’i nxisin nxënësit të shprehin aftësitë e tyre krijuese në mënyrë praktike dhe me imagjinatë, duke përdorur varietete formash: fjalë, grafikë, modele etj.
- Të sigurojë një kontekst, në të cilin nxënësit mund të zbulojnë dhe vlerësojnë ndikimin e teknologjive në ekonomi, në shoqëri dhe në mjedisin përreth.

Qëllimi i programit të TIK-ut:


Programi i TIK-ut për ciklin fillor do të bazohet kryesisht në zhvillimin e procesit të shkruarit në kompjuter, bashkëbisedimit me të tjerët, si edhe realizimit të prezantimeve të ndryshme. Nxënësit do të aftësohen:

- të gjejnë informacione nga një shumëllojshmëri burimesh, të përzgjedhin dhe të sintetizojnë informacionin për të përmbushur nevojat e tyre;
- të zhvillojnë idetë e tyre duke përdorur mjete të TIK-ut për të përmirësuar cilësinë, për ta ndryshuar dhe përsosur punën e tyre;
- të shkëmbejnë dhe të ndajnë informacione përmes medieve elektronike;
- të shqyrtojnë, të ndryshojnë dhe të vlerësojnë punën e tyre, duke reflektuar në mënyrë kritike për cilësinë e saj.

3 Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për ta realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. **Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.**

Kompetenca demonstron nga nxënësi (njohuri), bazohet në performancën e tij (aftësi), si dhe bazohet në perspektivën e sjelljes (qëndrim).



Organizimi i mësimi të TIK-ut me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Kur nxënësi realizon kompetencat digjitale, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe.

Përshembull; kompetenca digjitale “Zgjidhja problemore” përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme duke përdorur teknologjinë.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës së TIK-ut mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultat-in/et e të nxëniti për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëniti për kompetenca kyçe për secilin vit mësimor rezultat-in/et e të nxëniti për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultat-in/et e të nxëniti për shkallë për kompetencat e fushës/ lëndës së TIK-ut që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxëniti për kompetencat e fushës/lëndës së TIK-ut për vit mësimor, rezultat-in/et e të nxëniti për shkallë;
- përzgjedh përmbajtje-en/et mësimore, mjetet digjitale, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxëniti të kompetencave digjitale një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxëniti për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxëniti brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxëniti për vit mësimor dhe shkallë për fushën e teknologjisë dhe TIK-ut.

Diagrama 2 Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së TIK-ut për shkallën e dytë.

Kompetenca digjitale

- **Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin**
 - Njeh disa mjete të thjeshta të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
 - Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit të mos jetë më shumë se një faqe teksti .
 - Realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.
 - Kuptojnë rëndësinë e ruajtjes së të dhënave individuale (emri, mbiemri, adresa e shtëpisë, moshë...) dhe mos publikimit të tyre në asnjë burim informacioni të pa licencuar.
 - Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar.
 - Organizon dhe komunikon informacionin, duke përdorur mjetet e duhura të komunikimit teknologjik për të mbledhur informacion dhe për të komunikuar me të tjerët (p.sh. e-mail, internet, video-konferencë, word-processor, krijon postera mbi një temë të caktuar).
 - Zhvillon vetëdijen kulturore dhe të kuptuarit global duke u angazhuar me nxënësit e kulturave të tjera nëpërmjet komunikimeve online.
 - Organizon, mbledh dhe shfaq të dhënat e gjetura nga burimet e informacionit elektronik.
 - Identifikon dhe përdor bazën e të dhënave të sigurta dhe të përshtatura për moshën e tij, nëpërmjet burimeve elektronike apo të shtypit.
 - Jep shembuj të punës me teknologjitë, të zgjidhjeve, që na ofron në jetën e përditshme, në bazë të të cilave ne marrim vendimet tona.
 - Është i qartë për konceptin e përdorimit të sigurtë të teknologjisë, duke u fokusuar edhe në mbrojtjen e të dhënave personale.
 - Demonstron sjellje pozitive dhe etike, kur përdor teknologjinë si një mjet komunikimi ose shërbimi apo krijimi të një produkti.

Kompetenca e të menduarit

- **Nxënësi mendon në mënyrë krijuese**
 - Identifikon për një temë/ngjarje, çështjet kryesore të marra nga burime digjitale të ndryshme informacioni (internet).
 - Ndërton tekste, objekte, animacione sipas imagjinatës duke përdorur TIK.

Kompetenca e të nxënit

•Nxënësi mëson për të nxënë

- Identifikon njohuritë që ka ,të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo veprimtari të caktuar dhe kërkon këshilla e informacion për kapërcimin e vështirësive.
- Shfrytëzon burime të ndryshme informacioni për përgatitjen e një teme të dhënë.
- Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informacionin /njohuritë për zgjidhjen e një problemi /detyre të caktuar, përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo burimeve të tjera.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

•Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive

- Përgatit një autobiografi ku prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet, që ka për fusha të caktuara, duke gjetur të përbashkëta,që ato kanë me profesionet e dëshiruara.
- Përgatit një plan pune një javor dhe specifikon veprimtaritë prioritare duke argumentuar përzgjedhjen e tyre.
- Përgatit një projekt të vogël, duke theksuar veprimtaritë kryesore për një çështje , që e shqetëson në shkollë ose komunitet dhe përcakton kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për zbatimin e tij.

Kompetenca personale

•Nxënësi bën jetë të shëndetshme

Kompetenca qytetare

•Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët

- Përdor teknologjitë për të përfituar shërbime dhe për të marrë pjesë aktive në jetën civile.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

•Nxënësi komunikon në mënyrë efektive


- Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në një kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un.

4 Lidhja e TIK-ut me fushat e tjera kurrikulare

TIK-u u shërben të gjitha fushave, me koncepte dhe me aftësi. Lidhja e TIK-ut me fushat e tjera pasuron situatat e të nxënit, në të cilat nxënësi zhvillon kompetencat e tij. Përdorimi i teknologjisë në fushat si (“Gjuhët dhe komunikimi”, “Matematikë”, “Shkencat e natyrës”, “Artet”, “Shoqëria dhe mjedisi”) ndihmon në përvetësimin më mirë të lëndëve të tjera nga nxënësi duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më efektive. TIK-u luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fushat e tjera. TIK-u u shërben nxënësve të zhvillojnë jo vetëm kompetencën digjitale, po i ndihmon ata t’i zhvillojnë më shumë këto kompetenca duke ndërlidhur njohuritë e TIK-ut me njohuritë e fushave të tjera. TIK-u mund të shihet si një lëndë që përbëhet nga mediat që çdo nxënës mëson t’i përdorë gjatë procesit mësimor, por ndërkohë është e rëndësishme që nxënësi të mësojë se si t’i përdorë këto media në funksion të fushave mësimore. Sipas Bibeau-t (2004a): “TIK-u në edukim, përveç përmirësimit të mënyrave të komunikimit, të menaxhimit dhe të përmirësimit të procesit të mësimdhënies, ka edhe një avantazh tjetër. Avantazhi i tij është se mundëson të nxënit gjatë gjithë jetës, forcon lidhjet nëpërmjet shkëmbimit të përvojës me vendet e zhvilluara, mundëson relacione pedagogjike në distancë në çdo situatë dhe një komunikim direkt pa humbje informacioni. Gjithashtu, siguron vazhdimësi gjatë gjithë kohës, duke përmirësuar procesin e të nxënit në klasë dhe jashtë saj”.

Një ide e shfrytëzimit të mekanizmave të TIK-ut në lëndët e tjera do të ishte p.sh përdorimi i Excel për llogaritje në lëndën e matematikës ose gjetja e eksperimenteve online për të kuptuar më mirë konceptet në kimi, biologji, fizikë apo përdorimi i faqeve të sigurtat të internetit për realizimin e projekteve kurrikulare. Në fushën e gjuhës dhe komunikimit nxënësit vënë në praktikë shkrimin e saktë të teksteve, përvetësojnë shqiptimin e fjalëve, apo komunikojnë me bashkëmoshatarë të vendeve të tjera duke përdorur gjuhët e huaja. Nxënësi rrit njohuritë e tij në fushën e historisë nëpërmjet TIK-ut duke përdorur internetin për të gjetur fakte historike, imazhe etj. Gjithashtu në studimin e edukimit muzikor nxënësi nëpërmjet njohurive në TIK-ut ndjek imazhe vizualisht ose krijon pjesë të vogla muzike.

Diagrama 3 Lidhja ndërmjet tik-ut dhe fushave të tjera.



5 Kompetencat që formohen përmes tematikave

Bazuar në këtë kurrikul, programi i TIK-ut synon të përmbushë 6 kompetencat e fushës/lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 5 tematikave kryesore.

Digrama 4 Kompetencat e fushës dhe tematikat e fushës.:




Tabela 1: Kompetencat e fushës dhe përshkrimi i tyre

Kompetencat e veçanta që formohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave
Kreativiteti dhe inovacioni	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë:</i> përdor teknologjinë për të zhvilluar të menduarit kritik dhe krijues apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin gjatë përdorimit të produkteve në proceset e punës së tij. - <i>Zhvillimi i përmbajtjes:</i> të krijojë përmbajtje në formate të ndryshme duke përfshirë multimedia, të rregullojë dhe të përmirësojë përmbajtjen që ai ose të tjerët kanë krijuar, të shprehë kreativitetin nëpërmjet mediave dhe teknologjive digjitale. - <i>Integrimi dhe ripërpunimi:</i> të modifikojë, të pastrojë dhe të përpunojë burimet ekzistuese për të krijuar përmbajtje dhe njohuri të reja, origjinale dhe të përshtatshme. - <i>E drejta e autorit dhe licencat:</i> të kuptojë si e drejta e autorit dhe licencat zbatohen në gjetjen e informacionit dhe përmbajtjes digjitale. - <i>Programimi:</i> të aplikojë parametrat, të modifikojë programe, të aplikojë programe, software, të kuptojë parametrat e programimit, të kuptojë çfarë ka pas një programi.
Komunikimi dhe bashkëpunimi	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Bashkëveprimi ndërmjet teknologjisë:</i> të bashkëveprojë nëpërmjet llojeve të ndryshme pajisjesh dhe aplikacionesh digjitale, të kuptojë se si komunikimi digjital është shpërndarë, paraqitur dhe drejtuar, të kuptojë rrugët e përshtatshme të komunikimit nëpërmjet mjeteve digjitale, t'u referohet formateve të ndryshme të komunikimit, të përshtasë modelet dhe strategjitë e komunikimit për një audiencë specifike. - <i>Shpërndarja e informacionit dhe përmbajtjes:</i> të ndajë me të tjerët vendndodhjen dhe përmbajtjen e informacionit të gjetur, të jetë i gatshëm dhe në gjendje për të ndarë njohuritë, të veprojë si ndërmjetës, të jetë aktiv në shpërndarjen e të reja, përmbajtjeve dhe burimeve, të dijë rreth praktikave dhe të integrojë informacion të ri në trupin e njohurive ekzistuese. - <i>Angazhimi i qytetarisë online:</i> të jetë i vetëdijshëm për potencialin e teknologjive për pjesëmarrjen e qytetarëve. - <i>Etika e komunikimit online:</i> të dijë dhe të njohë si janë rregullat e sjelljes online/ ndërveprimet virtuale, të jetë i vetëdijshëm për aspektet e diversitetit kulturor, të jetë i aftë të mbrojë veten nga rreziqet e mundshme online, të zhvillojë strategji aktive për të zbuluar sjelljet e papranueshme.
Kërkimi dhe gjetja e	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Shfletosja, kërkimi dhe filtrimi i informacionit:</i> të hyjë dhe të kërkojë informacion online, të gjejë informacionin e përshtatshëm, të zgjedhë burimet efektive, të lundrojë ndërmjet burimeve online,

<p>informacionit</p>	<p>të krijojë strategji personale informacioni.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i informacionit: të mbledhë, përpunojë, kuptojë dhe të vlerësojë në mënyrë kritike informacionin. - Ruajtja dhe rigjetja e informacionit: të ndryshojë dhe të ruajë informacionin dhe përmbajtjen për korrigjim më të lehtë, të organizojë informacione dhe të dhëna.
<p>Mendimi kritik, problem-zgjidhës dhe vendimmarrja</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Zgjidhja e problemeve teknike: të gjejë problemet e mundshme dhe t'i zgjidhë ato (nga troubleshooting në zgjidhjen e problemeve më komplekse) me ndihmën e mjeteve digjitale. - Gjetja e nevojave dhe përgjigjeve teknologjike: të vlerësojë nevojat e veta në termat e burimeve, mjeteve dhe zhvillimit të kompetencave, të përshtasë nevojat me zgjidhjen e mundur, të adaptojë mjetet me nevojat personale, të vlerësojë në mënyrë kritike zgjidhjet e mundshme dhe mjetet digjitale. - Gjetja e boshllëqeve të kompetencave digjitale: të kuptojë kur kompetencat e veta që nevojiten të përmirësohen ose të përditësohen, të mbështesë të tjerët në zhvillimin e kompetencave të tyre digjitale.
<p>Mbrojtja</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Mbrojtja e pajisjeve: të mbrojë pajisjet e veta dhe të kuptojë rreziqet online dhe kërcënimet, të marrë njohuri rreth mbrojtjes dhe masave të sigurisë. - Mbrojtja e të dhënave personale: të kuptojë termat e zakonshëm të shërbimit, të aktivizojë mbrojtjen e të dhënave personale, të kuptojë privatësinë e njerëzve të tjerë, të mbrojë veten nga mashtrimet në internet dhe kërcënimet. - Mbrojtja e shëndetit: të shmangë rrezikun e shëndetit që lidhet me përdorimin e teknologjisë në termat e kërcënimeve në të mirën e shëndetit fizik dhe psikologjik. - Mbrojtja e mjedisit: të jetë i vetëdijshëm për ndikimin e TIK-ut në mjedis.

6 Koha mësimore për secilën klasë

Lënda e TIK-ut zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 35 orë mësimore për secilën klasë. Programi i lëndës së TIK-ut specifikon kohën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

	Bota e kompjuterit	Përpunimi digjital i të dhënave	Kreativiteti dhe programimi	Kërkimi në web/internet	Siguria në internet dhe siguria e të punuarit në kompjuter	Gjithsej orë
Shkalla e dytë						70 orë
Klasa e pestë	8 orë	9 orë	7 orë	7 orë	4 orë	35 orë

6.1 Përmbajtja e shkallës së dytë

Në programin e fushës/lëndës së TIK-ut për shkallën e dytë janë paraqitur përmbajtjet e tematikave:

- *Bota e kompjuterit;*
- *Përpunimi digjital i të dhënave;*
- *Kreativiteti dhe programimi;*
- *Kërkimi në web/internet;*
- *Siguria në internet dhe siguria e të punuarit në kompjuter;*

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera. Tematikat janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënësve sipas

kompetencave digjitale. Shkalla e dytë është e përbërë nga dy klasa, klasa e katërt dhe e pestë. Për secilën klasë janë paraqitur tematikat dhe për çdo tematikë janë përcaktuar njohuritë. Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle për secilën shkallë.

Koha për secilën tematikë lidhet së pari me rëndësinë e tematikës dhe së dyti me shkallën e vështirësisë së saj për t'u përvetësuar nga nxënësit. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Mësuesit janë të lirë të ndryshojnë me 10% (më shumë ose më pak) orët e rekomanduara për secilën tematikë. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, si dhe ndarjen e orëve sipas tematikave. Në programin e ciklit fillor mësuesit duhet të kenë në konsideratë që kjo lëndë fillon për herë të parë për nxënësit në klasën e katërt. Që nxënësit të aftësohen në këtë lëndë, ata duhet të kenë në dispozicion orë që ju mundësojnë praktikimin e njohurive të reja.

Programi i TIK-ut **për klasën e 5-të** zhvillohet me 1 orë në javë, në **35 orë mësimore vjetore**.

Mësuesit dhe hartuesit e teksteve janë të lirë t'i organizojnë kapitujt dhe renditjen e tyre, por ajo që është e rëndësishme dhe duhet marrë në konsideratë është se tematikat zgjasin përgjatë gjithë vitit shkollor dhe si të tillë kapitujt e teksteve nuk mund të jenë të ndarë, por duhet të kenë ndërlidhje dhe vazhdimësi. Gjithashtu mësuesit duhet të marrin në konsideratë që situatat janë në qendër të zhvillimit të orës mësimore dhe nëpërmjet situatave të synohet arritja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Ndaj do të ishte dhe në ndihmë të mësuesit nëse tekstet do të ishin të pasura me situata praktike të marra nga jeta e përditshme.

7 SHKALLA E DYTË

SHKALLA E DYTË Klasa e pestë

7.1 Tematika: Bota e kompjuterit

Përshkrimi i tematikës: Nxënësi njihet me botën e TIK, me teknologjinë kompjuterike, me rëndësinë, funksionet dhe ndikimin që kjo teknologji ka në shoqërinë tonë. Kjo tematikë prezanton nxënësit me kompjuterin dhe pjesët përbërëse të tij, shpjegon lidhjen midis TIK-ut dhe lëndëve të tjera dhe synon zhvillimin e mendimit kritik në lidhje me përdorimin e teknologjisë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- *Kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë:*

Nxënësit përdorin kompjuterin për të zhvilluar të menduarit kreativ dhe konstruktiv dhe për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin.

- *Komunikimi dhe bashkëpunimi:*

Nxënësit ndërveprojnë, bashkëpunojnë dhe publikojnë me moshatarët apo të tjerët duke përdorur kompjuterin; përdorin media dhe formate të ndryshme për komunikimin e informacionit dhe ideve në mënyrë efektive; përcaktojnë strategjinë e kërkimit të informacionit; gjejnë, organizojnë, analizojnë, vlerësojnë, përpunojnë dhe përdorin informacionin nga një shumëllojshmëri e burimesh.

- *Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:*

Nxënësit identifikojnë problemet e mundshme të vogla teknike dhe i zgjidhin ato (defektet e vogla).

- *Operationet baze dhe konceptet teknologjike:*

Nxënësit kuptojnë dhe përdorin saktë sistemet e teknologjisë; përzgjedhin dhe përdorin aplikacionet në mënyrë efektive dhe produktive;

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

NJOHURITË KLASA 5

Bota e kompjuterit

Nxënësit:

- është i vetëdijshëm për rreziqet e punës në kompjuter si pasojë e

- njihen me pjesët e brendshme të kompjuterit më në detaje (karta e zërit dhe e videos, motherboard-i, procesori).
- kuptojnë procesin hyrës/dalës të informacionit në kontekstin e kompjuterave;
- mësojnë të konfigurujnë kompjuterin duke ndryshuar parametrat (si parametrat e sfondit, të ekranit, të Desktop-it, etj);
- mësojnë të organizojnë dokumentet në dosje dhe skedare (krijojnë, kopjojnë, fshijnë);
- kuptojnë si të gjejnë dokumentet duke përdorur ndërfaqen grafike;
- njihen me disa aplikacione lehtësisht të përdorshme si Makina llogaritëse (Calculator), Media Player;
- njihen me ndërfaqen grafike të software-it për përdoruesin;
- familjarizohen me elementët kryesorë të dritares së një programi.

- mosrespektimit të rregullave të përdorimit të kompjuterit (veprimet që priten të ndërmerren: nxënësit rregullojnë ekranin dhe dritën kur punojnë në kompjuter, shmangin zhurmën dhe dëgjimin me zë të lartë të muzikës ose filmave, etj);
- është i aftë të dallojë pajisjet dhe pjesët përbërëse të kompjuterit.
- është i aftë të dallojë pjesën hardware dhe software të një sistemi kompjuterik;
- është i aftë të zgjidhë një problem të thjeshtë teknik;
- është i aftë të mirëmbajë kompjuterin e tij;
- është i aftë të krijojë, kopjojë dhe fshijë dosje dhe skedarë si dhe është në gjendje t'i kërkojë ato;
- është i aftë të organizojë

Qëndrime dhe vlera:**Nxënësi:**

- Është i përgjegjshëm gjatë përdorimit të mjeteve teknologjike.
- Kupton rëndësinë e TIK-ut në aspekte të ndryshme të jetës së përditshme.
- Është i gatshëm të ndajë ide dhe të bashkëpunojë me të tjerët.
- Është i gatshëm të jetë pjesë e ekipit.
- Merr pjesë aktive në zgjidhjen e problemit.
- Është i gatshëm të kërkojë këshilla kur shfaqet një problem.
- Mendon alternativat kur problemet nuk janë zgjidhur .
- Zbaton rregullat e mirëmbajtjes së kompjuterit.
- Është i vetëdijshëm për kohën e qëndrimit para kompjuterit.

Veprimtari sugjeruese:

Në laboratorin informatik, nxënësit njihen në mënyrë konkrete me pjesët e kompjuterit, mesazhet e sistemit operativ, programeve dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

7.2 Tematika: Përpunimi digjital i të dhënave

Përshkrimi i tematikës: Nxënësi përdor mjetet digjitale për të mbledhur, analizuar, vlerësuar, përpunuar dhe raportuar informacione nga burime të ndryshme elektronike, të cilat janë në përshtatje me moshën dhe me qëllimin e detyrave.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- *Kreativiteti dhe inovacioni:*

Nxënësi aplikon njohuritë ekzistuese për të gjeneruar ide, produkte ose procese të reja; realizon një/disa punim/-e origjinal/vetjak/-e si një mjet shprehës personal apo të grupit; përdor modelet dhe simulimet për të analizuar problemet dhe sistemet komplekse.

- *Kërkimi dhe gjetja e informacionit:*

Nxënësi klasifikon të dhënat në grupe. dhe kupton që pajisjet e jetës së përditshme përgjigjen ndaj sinjaleve dhe udhëzimeve; krijon strategji personale informacioni; mbledh, përpunon, kupton dhe vlerëson në mënyrë kritike informacionin; nryshon dhe ruan informacionin dhe përmbajtjen për korrigjim më të lehtë, organizon informacione dhe të dhëna.

- *Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:*

Nxënësi identifikon problemet dhe përcakton pyetjet e duhura për hulumtim; planifikon dhe menaxhon aktivitetet për arritjen e zgjidhjeve ose për të përfunduar një projekt; mbledh të dhënat, i analizon, identifikon dhe vendos zgjidhjet e duhura; përdor procese multiplikative dhe shqyrton perspektivat e ndryshme për të eksploruar zgjidhjet alternative.

- *Operacionet bazë dhe konceptet teknologjike:*

Nxënësi kupton dhe përdor saktë sistemet e teknologjisë; përzgjedh dhe përdor aplikacionet në mënyrë efektive dhe produktive; njohuritë e fituara i vë në funksion të mësimin të teknologjive të reja.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<p>NJOHURITË KLASA 5</p> <p>Përpunimi digjital i tekstit</p> <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kuptojnë dallimin midis të dhënave, informacionit dhe dokumentit; • kuptojnë që teksti përfaqëson të dhënat që duhet të përpunohen nga ana e software-it; • kuptojnë që teksti mund të ndryshohet në tipe të ndryshme shkrimi, madhësie dhe stili; • nëpërmjet komandave specifike zbatojnë rregullat e drejtshkrimit për shkrimin e tekstit (p.sh. <i>paragraph indent; increased space</i>); • kuptojnë se si të kërkojnë dhe gjejnë të dhëna në tabela dhe të identifikojnë gabimet; • kuptojnë që gabimet mund të ndikojnë tek rezultatet e kërkimit dhe vendimet bazohen në të dhënat; • kuptojnë procesin e verifikimit dhe vlerësimit të të dhënave; • kuptojnë ndryshimin e komandave Save dhe Save As. • rigjejnë informacionin që është ruajtur. 	<p>Përpunimi digjital i të dhënave</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - është i aftë të përdorë paketat bazë për krijimin e përmbajtjes në forma të ndryshme (tekst, tabela, audio, imazh etj) - është i aftë të hapë ose të krijojë një dokument duke përdorur programet përkatëse; - është në gjendje të përdorë në mënyrën e duhur tastierën dhe mausin për realizimin e detyrës. - është i aftë të përpunojë një tekst të gatshëm sipas detyrës së kërkuar. - organizon dhe menaxhon të dhënat në kompjuter. Mund të krahasojë, të bëjë dallimin

dhe të integrojë informacionin nga burime të ndryshme.

- strukturon dhe klasifikon informacionin dhe përmbajtjen sipas një skeme/metode klasifikimi.
- Shkarkon/ngarkon informacionin dhe përmbajtjen e klasifikuar .

Qëndrime dhe vlera

Nxënësi:

- ndërton strategji për kërkimin e informacionit.
- është i motivuar për të qenë i saktë.
- vlerëson aspektet pozitive të teknologjive për korrigjimin e informacionit.
- është i motivuar të kërkojë mjete të ndryshme teknologjike për të përmbushur kreativitetin.
- është kurioz rreth sistemeve të informimit dhe funksioneve të tyre.

Veprimtaritë sugjeruese:

- Në kompjuter shfaqen fotot e tasteve të tastierës së kompjuterit, nxënësit do të përshkruajnë funksionin e secilit prej tyre.
- Nxënësi regjistron të gjithë librat e librarisë së tij në një dokument elektronik, vendos për të dhënat e librit që duhet të ruhen, klasifikon librat dhe korrigon gabimet në hedhjen e të dhënave.
- Përgatit një dokument për ta publikuar në Website-in e shkollës. Dokumenti duhet të përmbajë lloje të ndryshme të dhënash si tekst, figura dhe zë.
- Përdor programe për të shkruar shpejt në kompjuter.

7.3 Tematika: Kreativiti dhe programimi

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë kombinon kreativitetin me programimin. Nxënësi realizon objekte dhe veprimtari të ndryshme duke përdorur programe. Ai mbledh, përpunon, prezanton, lexon dhe interpreton figura për t'i përdorur ato në krijimet e tij vizuale, në këtë mënyrë ai mëson si të përcjellë vizualisht idetë/mesazhet e tij. Kjo tematikë u mundëson nxënësve të projektojnë dhe të vizatojnë me pak mund, por me shumë kreativitet në sajë të programimit dhe mjedisve zhvilluese që i bëjnë të mundur këto krijime.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- *Kreativiteti dhe prona intelektuale:*

Nxënësit përdorin programimin, programet dhe eksperiencat online për të krijuar produkte digjitale bazuar në frymëzimin e tyre artistik; integrojnë mënyrat e ndryshme artistike me të menduarit në mënyrë kritike; mbrojnë të drejtat e autorit përkundrejt krijimive të tyre;

- *Shpërbërja e problemeve:*

Nxënësit zbulojnë që figurat gjeometrike të ndërlikuara mund të vizatohen hap pas hapi duke përsëritur të njëjtat veprime bazike;

- *Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:*

Nxënësit identifikojnë një model standard dhe e ripërdorin për të krijuar produktet e tyre digjitale sipas disa specifikave.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<p>NJOHURITË KLASA 5</p> <p>Kreativiteti dhe programimi (Sugjerimi kryesor: Microsoft Windows Logo)</p> <ul style="list-style-type: none">• njohin konceptet e programimit nëpërmjet vizatimit;• kuptojnë dhe përshkruajë hapat e ndjekur për të kryer një vizatim;• kuptojnë si të kryejnë detyra të jetës së përditshme dhe se si t'i ekzekutojnë në kompjuter (Vizatojnë viza, katrorë, drejtkëndësha dhe i bashkojnë në një figurë të vetme)• përsërisin për të ndërtuar objekte më komplekse (Përdorin figurat e mëparshme për të krijuar figura të reja);	<p>Kreativiteti dhe programimi</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">- është në gjendje të përshkruajë hap pas hapi aktivitetet e jetës së përditshme- njeh që kompjuteri vetëm ekzekuton udhëzimet e një programi;- vizaton dhe shpreh idetë /

<ul style="list-style-type: none"> • përdorin komandat e programit për të levizur, fshirë apo shtuar objekte. • kuptojnë që përsëritja e instruksioneve në program i ndihmon ato për të ndërtuar më shpejt një produkt (p.sh përdorin komandën Repeat për të krijuar një hark); • kuptojnë që një program kompjuterik është thjesht një tërësi hapash që i tregon kompjuterit se çfarë të bëjë; • kuptojnë që detyra apo produkte të ndryshme mund të realizohen duke krijuar një program kompjuterik. 	<p>frymëzimin artistik duke e mbështetur në mendimin kritik;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor përsëritjen e udhëzimeve për të zgjidhur problemin më shpejt; - është i aftë të modifikojë krijimin ose përmbajtjen me mënyra të thjeshta; - është në gjendje të redaktojë përmbajtjen në mënyrë që të përmirësojë variantin përfundimtar. - është në gjendje të përdorë një shumëllojshmëri të objekteve multimediale për të shprehur kreativitetin (tekst, imazhe, audio dhe video).
<p>Qëndrime dhe vlera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - reflekton në mënyrë kritike rreth programeve të krijuara për t’u përmirësuar në ushtrimet e radhës; - shpërbën problemin në nën-probleme dhe përdor shënime të veçanta për ta përfaqësuar atë; - përdor mjetet e programimit që i përshtaten punës dhe kontakteve të ndryshme; 	
<p>Veprimtaritë sugjeruese:</p> <p>Nxënësi duhet t’i shkruajë shokut një bashkësi me udhëzime për të ndërtuar një figurë.</p>	

Krijon një album me foto rreth një teme specifike si pushimet, gjallesat dhe bimësia mesdhetare etj. dhe e prezanton në klasë.

Ndërton në kompjuter figura apo vizatime që lidhen me lëndët e tjera.

7.4 Tematika: Kërkimi në web/internet

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë trajton Web-in (apo World Wide Web) si një mjet i fuqishëm për kërkimin dhe gjetjen e informacionit dhe nxitjen e kërkimit shkencor. Kjo tematikë u jep nxënësve njohuritë rreth Internet-it, se si ai lejon komunikimet midis njerëzve dhe makinave si dhe shpjegon lidhjen midis Internet-it dhe Web-it. Gjthashtu, kjo tematikë fokusohet tek shfletuesit (browser-at) dhe roli i tyre, teknikat për të realizuar kërkime efikase dhe përdorimin e informacionit të gjetur.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- *konceptet teknologjike*

Nxënësit shpjegojnë se si sistemet e komunikimit dhe zgjidhjet përkatëse kënaqin kërkesat njerëzore në kuadër të realizimit të ndërlidhjes.

- *mendimi kritik*

Nxënësit përdorin klasifikimin për të zhvilluar një kërkim rezultativ, shfrytëzojnë renditjen e motorëve të ndryshëm të kërkimit për të gjetur faqe ueb-i të caktuara.

- *rrjedhojat morale dhe etike të përdorimit të kompjuterave*

Nxënësit mësojnë të respektojnë të drejtat e autorësisë dhe të privatësisë në një botë që bëhet gjithmonë dhe më e ndërlidhur.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
	Kërkimi në web/internet
NJOHURITË KLASA 5 Kërkimi në web/internet <ul style="list-style-type: none"> • kuptojnë që Internet-i mbështet shumë shërbime si Web, email, VOIP, etj. • kuptojnë lidhjen midis serverave Web, shfletuesve Web, Website-ve dhe faqeve Web; 	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - është në gjendje të dallojë web-browser të ndryshëm - është në gjendje të kërkojë informacion nëpërmjet fjalëve të cilat kufizojnë

- kuptojnë që roli i motorëve të kërkimit konsiston në gjetjen e një faqeje web të caktuar
- kuptojnë që motorët e kërkimit i rendisin faqet web të gjetura sipas kritereve;
- kërkojnë informacion në lidhje me një temë dhe rezultatin e ruajnë
- ruajnë adresat e website-ve të preferuara;
- lundrojnë në mënyrë të sigurt;
- kuptojnë çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes nga një prespektivë teknike.

numrin e gjetjeve të tepërta

- është në gjendje të evidentojë të drejtën e pronësisë së një përmbajtjeje.
- është në gjendje të gjejë grupime, rrjete apo media sociale përkatëse që u korrespondojnë interesave dhe nevojave të tij/saj.
- di si të gjejë informacionin sipas rregullave të së drejtës së autorit dhe licensave;
- rigjen informacionin e kërkuar dhe zgjedh fjalorin e duhur specifik në mjetet e kërkimit
- vlerëson dobinë, saktësinë dhe integritetin e informacionit.

Qëndrime dhe vlera:

Nxënësi:

- përdor Web-in për të gjetur informacion në lidhje me detyra të ndryshme;
- është i motivuar të kërkojë informacione për aspekte të ndryshme të jetës së tij/saj;
- është i sigurt dhe i qetë gjatë komunikimit dhe shprehjes nëpërmjet mediave digjitale;
- është i vetëdijshëm për kodin e mirësjelljes në përshtatje me mjedisin online;
- është i vetëdijshëm për rrezikun lidhur me komunikimin online me persona të panjohur;

- merr vendime në lidhje me mjetet e komunikimit që duhet të përdorë;
- respekton të drejtat e autorësisë dhe licensat;
- shmang plagjiaturën në mënyrë të vetëdijshme;
- merr qëndrim aktiv në shpërndarjen e burimeve, përmbajtjes dhe njohurive;
- zhvillon mendimin kritik rreth medias sociale, rrjeteve dhe komunikimeve online.

Veprimtaritë sugjeruese:

- Japin argumente rreth faktit që informacioni i gjetur në Web nuk është gjithmonë i saktë.
- Zhvillojnë një strategji që mund të ndihmojë në garantimin e saktësisë së informacionit.
- Përdorin e mail-et për të komunikur midis tyre dhe ndjekin disa modele të gatshme për këtë

7.5 Tematika: Siguria në internet dhe e punës në kompjuter

Përshkrimi i tematikës: Nxënësit njihet me rreziqet që vijnë nga përdorimi i Internet/Web-it dhe këshillohen rreth informacionit që duhet të publikojnë si dhe rregullat etike që duhet të ndjekin gjatë përdorimit të Web-it.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- *Mësimi dhe përshtatja e një sjelljeje për lundrim të sigurt në Web:*

Nxënësit identifikojnë masat që duhet të ndër marrin për të mbrojtur privatësinë e tyre në Internet; konfigurujnë funksionet e shfletuesit për të qënë të sigurt në Internet.

- *Ndërgjegjësim për pasojat e ndarjes së informacionit me të tjerët*

Nxënësit ndërveprojnë në mënyrë të sigurt online duke përdorur rrjetet sociale; kuptojnë pasojat e postimeve online.

- *Njohin dhe shmangin “kurthet” online të cilat mund të kompromentojnë sigurinë e tyre*

Nxënësit zbatojnë bazat për sigurinë dhe mbrojtjen gjatë qëndrimit online; zhvillojnë strategji për të adresuar fshehtësinë e tyre dhe çështjet e lidhura me të.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
	Siguria në internet dhe siguria e të

NJOHURITË KLASA 5

Botimet dhe siguria në internet

Nxënësit:

- kuptojnë nevojën për autentifikim dhe autorizim në llogaritë virtuale;
- përdorin me kujdes informacionet personale dhe fjalëkalimet;
- bëjnë kujdes për t'u mos ekspozuar në Web;
- kuptojnë funksionimin e rrjetit social për të shmangur rreziqet e rënies në grackë nëpërmjet nxjerrjes së informacioneve private, të ndjeshme ose të kontaktit me individë të padëshiruar;
- kuptojnë anët pozitive dhe negative të publiciteteve që lidhen me përdorimin e *videogame*-ve apo me përdorimin e mjeteve të tjera elektronike.

punuarit në kompjuter

Nxënësi:

- tregon kujdes gjatë punës së tij online.
- është i aftë të dallojë situata të papërshtatshme për të;
- bën dallimin midis komunikimeve të jetës së përditshme dhe atyre virtuale;
- është i aftë të përdorë shërbimet digjitale dhe avantazhet e rrjeteve sociale pa krijuar varësi nga ato;
- është në gjendje të nxjerrë përfundime rreth sjelljeve “të mira” dhe “të këqija” gjatë qëndrimit online.

Qëndrime dhe vlera:

- është i vetëdijshëm që përdorimi i pakujdesshëm i Internet/Web-it mund t'u shkaktojë probleme;
- raporton çdo situatë të papërshtatshme si pasojë e përdorimit të Internet/Web-it;
- tregon kujdes ndaj llojeve të ndryshme të tërheqjeve në Internet si reklamat, spam-et, lojërat, etj.;
- sillet sipas rregullave morale dhe etike jo vetëm në jetën e përditshme, por edhe në botën virtuale.

Veprimtaritë sugjeruese:

- Identifikon rregullat që duhen zbatuar në rrjetet sociale. Përgatit broshura duke përdorur figura, objekte dhe tekste për të treguar ndërgjegjësimin e tyre rreth përdorimit të Web-it, përmendin tri sjellje të rrezikshme në internet që duhen shmangur.
- Loja e hetuesit: çdo nxënës përgatit në kompjuter një dokument me versionin e tij rreth skenës së ngjarjes sipas disa kërkesave që janë të

përcaktuara paraprakisht. Kështu, ai duhet të tregojë të vërtetën rreth vendit se ku ndodhej, personat me kë po fliste dhe çfarë ishte duke bërë. Vetëm njëri prej tyre, “fajtori”, do të gënjehej rreth ngjarjes. Në bazë të këtyre dëshmimeve të mbledhura në kompjuter, prokurori duhet të zbulojë “fajtorin”.

8 Udhëzime metodologjike

TIK-u i ofron shkollës potenciale të shumëfishta, si për shembull: me ndihmën e kompjuterit dhe të internetit zhvillohet të nxënit bashkëpunues, autonom dhe problemzgjdhës. Kjo kërkon përdorimin e duhur të mjeteve teknologjike, si dhe njohjen specifike të tyre. Në përgjithësi njeriu mëson nëpërmjet fitimit ose shkëmbimit të informacionit, vëzhgimit, iniciativës vetjake për gjetjen e zgjidhjes së problemit ose duke u motivuar nga strategjitë e të nxënit. Potencialet e mjeteve teknologjike sot përfshijnë edhe ofrimin e shërbimeve në këto drejtime, duke bërë të mundur të nxënit p.sh: *kompjuteri me programet dhe mundësitë e tij, mund të kthehet në mjet burimor i informacionit dhe komunikimit, gjithashtu ai është mbështetës, ilustrues, prezantues, ndihmës, plotësues i materialeve mësimore*. Në këtë formë, mësues-i/ja gjatë lëndës së TIK-ut nuk ndihmon vetëm nxënësit të përvetësojnë njohuritë e reja, por i ndihmon ata t’i përdorin këto njohuri edhe në lëndët e tjera. Mbarëvajtja e orës së mësimit arrihet me sukses gjatë gërshetimit të këtyre komponentëve: njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve.

Njëra nga metodat më të sakta të përvetësimit të njohurive të TIK-ut, do të ishte realizimi i *projekteve kurrikulare* në mënyrë që nxënësit të vënë në praktikë njohuritë e marra, si edhe t’i gërshetojnë këto njohuri me njohuritë e lëndëve të tjera. Në arsimin fillor nxënësit nuk duhet të mbingarkohen gjatë orës së TIK-ut, por përkundrazi të mësojnë nëpërmjet lojës dhe praktikës. Ora e mësimit duhet të bazohet në një tematikë të përshtatur për moshën e nxënësit. Kompjuteri përdoret si mjet për të luajtur me programet, qoftë lojëra zbavitëse mësimore, qoftë programe për shkrim, prerje, prezantime, kërkim në internet ose komunikim. Në këtë mënyrë nxitet kreativiteti, zhvillohet motorika dhe nxitet të menduarit për zgjidhjen e problemeve. Suksesi i kësaj ore mësimore pasqyrohet sidomos në lirinë e fituar të nxënësit për t’i përdorur mjetet e TIK-ut. Nëpërmjet punës në grupe nxënësi vlerëson bashkëpunimin me shokët e shoqet e klasës, krijon lirshmërinë e vendimmarrjes dhe të përgjegjësisë ndaj komunitetit. Njohuritë e përfutuara gjatë orës mësimore bëhen më konkrete dhe më të realizueshme, nëse detyrat lidhen me veprimtaritë në

shkollë dhe me veprimtaritë që nxënësit mund të realizojnë jashtë shkollës. *Puna në grup* ose *në dyshe* jep mundësi për debat ose konsultim. Kështu zhvillohet përgjegjësia ndaj komunitetit ose komunikimi me të tjerë, duke fituar siguri vetjake, aftësi në përdorimin e saktë të mjeteve të TIK-ut me një synim të caktuar.

Për nxënësit e ciklit fillor, do të ishin të përshtatshme *metodat gjysmë kërkimore* për një problem të caktuar. Këto metoda i nxisin nxënësit të kërkojnë vetë në fillim zgjidhjen e problemit dhe më pas, të punojnë në grup për zgjidhjen e plotë të tij. Gjatë këtyre hapave mësues-i/ja ka rolin e lehtësuesit dhe i ndihmon ata të shkojnë drejt zgjidhjes së duhur.


Mësuesit duhet të përdorin edhe format e *pyetje-përgjigjes* para se të fillojnë shpjegimin e temës së re. Krijimi i një diskutimi në klasë është gjithnjë një atmosferë lehtësuese për nxënësit e këtij cikli. Ata vijnë me disa njohuri bazë në klasën e 4-t, ndaj është e rëndësishme që të fillojnë në fillim me atë që ata njohin dhe, më pas, me atë pjesë që ata nuk njohin.

Për zhvillimin sa më të mirë të kompetencës digjitale tek nxënësit, por dhe të kompetencave të tjera kyçe, është rëndësishme që e gjithë ora e mësimit të jetë e bazuar në situata konkrete, të cilat e kërkojnë zgjidhjen e problemit nëpërmjet zhvillimit në praktikë të njohurive të marra gjatë procesit mësimor.

9 Udhëzime për vlerësimin

Gjatë procesit të vlerësimit në klasë mësuesit duhet të kenë në fokus vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe realizimit të kompetencave kyçe, por dhe kompetencave të fushës. Që vlerësimi të bazohet mbi arritjet e nxënësve duhet të mbahen në konsideratë disa parime kryesore.


Parimet kryesore të vlerësimit



Vlerësimi formues duhet të jetë pjesë e situatave mësimore në të cilat ndodhen nxënësit. Gjithashtu është e rëndësishme që situatat mësimore të jenë komplekse në mënyrë që nxënësit të kenë më tepër lirshmëri për të dhënë zgjidhje problemore të ndryshme por edhe të zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues gjatë realizimit të situatës. Vlerësimi si proces lidhet me tërësinë e metodave, praktikave dhe teknikave që përdorin mësuesit për të testuar, për të kontrolluar, analizuar dhe për të matur nivelin e njohurive, aftësive dhe të performancës së nxënësve. Vlerësimi duhet të jetë i realizueshëm, i vlefshëm, korrekt, i besueshëm dhe i saktë. Vlerësimi duhet të japë një pasqyrë për arritjet e nxënësit, si edhe vështirësitë që mund të kenë nxënësit gjatë realizimit të detyrave ose projekteve kurrikulare. Të vlerësosh nxënësit nuk do të thotë vetëm t'i vendosësh atij një notë, por edhe ta ndihmosh atë të kalojë vështirësitë gjatë arritjes së kompetencave.

Në skemën në vijim jepet një shembull konkret se si mësuesi nisat nga situata e të nxënësve për të realizuar vlerësimin e nxënësve.


Hapat që mund të ndiqen për krijimin e një metodologjie vlerësimi që ndihmon në krijimin dhe vlerësimin e situatës.



Vlerësimi në klasë luan një rol të rëndësishëm në mënyrën se si mësojnë nxënësit, në motivimin e tyre për të nxënë dhe në mënyrën e shpjegimit të mësuesit. Pyetjet që lidhen me cilësinë (besueshmërinë, burimet e referencës, vlefshmërinë) janë të rëndësishme për të gjitha llojet e vlerësimit në klasë.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është që nxënësit të bëhen autonomë dhe të jenë në gjendje të vetëvlerësojnë progresin e tyre. Mësuesit zhvillojnë vetë dhe në bashkëpunim me nxënësit, një larmi mënyrash vlerësimi, që kanë të bëjnë me njohjen ose me familjarizimin me kompjuterin dhe pjesët e tij (në klasat e ulëta 1-2), si dhe me njohjen nga afër dhe përdorimin efektiv të tij (në klasat 3-5) etj. Vlerësimi bëhet në atë çka nxënësit kanë përvetësuar dhe janë të aftë të bëjnë. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Mësuesit nuk e kanë të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe vendosjen e notave në regjistër për secilën orë mësimore.

Gjatë kohës që bëhet planifikimi i programit ose i vlerësimit, është e rëndësishme që të bëhen pyetjet e mëposhtme: të cilat e ndihmojnë mësuesin të bëjë një vlerësim të bazuar në parime kryesore.



Në asnjë metodologji vlerësimi, qëllimi final nuk është që mësuesit ose vlerësuesit të arrijnë të përdorin të gjitha shkallët dhe tipat e vlerësimit (në të gjitha nivelet) në të njëjtën kohë. Dihet që mësuesit dhe vlerësuesit do të hasin vështirësi për të përdorur në të njëjtën kohë një numër të madh kategorish vlerësimi. Kështu del detyrë që në çdo praktikë vlerësimi, mësuesit dhe vlerësuesit duhet të përpiqen të zvogëlojnë numrin e

kategorive të mundshme në një sasi lehtësisht të manipulueshme. Përvoja ka treguar se 4-5 kategori kërkojnë një përqendrim maksimal, ndërsa 7 kategori përbëjnë një prag psikologjik që nuk mund të kapërcehet. Pra, duhet bërë një zgjedhje. *Një shembull konkret do të ishte:*

Nëse për realizimin e një detyre ka shumë kategori për t'u arritur, mësues-i/ja duhet të zgjedhë 4-5 kritere që mund të arrihen nga secili nxënës.

Kategoritë gjatë realizimit të një projekti kurrikular dhe punës në grup:

- **Strategji e marrjes së fjalës**
- Strategji të bashkëpunimit
- Kërkesë për sqarime
- **Lirshmëria**
- Fleksibiliteti
- Koherenca
- **Zhvillimi tematik**
- Saktësia
- Fusha e përgjithshme
- Shtrirja e fjalorit
- **Burimet e përdorura për realizimin e punimit**
- Respektimi i kohës së prezantimit
- **Qartësia e slide-ve**

Kriteret kryesore që duhen të merren parasysh dhe që ta vlerësojnë nxënës-in/en në mënyrë sa më objektive do të ishin:

- **Zhvillimi tematik**
- **Strategji e marrjes së fjalës**
- **Burimet e përdorura për realizimin e punimit**
- **Lirshmëria**

- **Qartësia e slide-ve**

Disa lloje vlerësimi:

a. Vlerësimi formues

Ky lloj vlerësimi duhet të realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga mësues-i/ja, në mënyrë që të kuptohen vështirësitë e nxënësve, më pas të shihet ecuria e tyre dhe në fund të kapitullit të shihet nëse janë arritur kompetencat e kërkuara. Për nxënësit e ciklit fillor, ky vlerësim është shumë i rëndësishëm dhe mund të realizohet nëpërmjet detyrave të shtëpisë. Lënda e TIK-ut nis për herë të parë për ta dhe duhet që herëpashere të sigurohemi që njohuritë të jenë kuptuar nga nxënësit. Gjatë këtij vlerësimi, mësues-i/ja duhet të vëzhgojë herëpashere nxënësit, të realizojë bashkëbisedime me ta, të realizojë produkte të ndërmjetme para produkteve finale. Ky lloj vlerësimi i ndihmon nxënësit të gjejnë mënyrën e duhur për të mësuarin efektiv.

b. Vlerësimi nëpërmjet portofolit

Një formë tjetër vlerësimi është edhe *vlerësimi nëpërmjet portofolit*, një formë që e ndihmon nxënësin të shohë se si ai avancon hap pas hapi. Portofoli i nxënësit është një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, i cili përmban një koleksion punimesh që ai organizon përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra shtëpie me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi/ja është në rolin e atij që drejton dhe rekomandon. Qëllimi kryesor i portofolit është që nxënës-i/ja të koleksionojë ato dokumente që atij mund t'i shërbejnë në vitet në vijim. Gjithashtu, në portofol, nxënës-i/ja mund të shohë se si ai/ajo përparon nga muaji në muaj ose nga semestri në semestër. Në ciklin fillor është shumë e rëndësishme që mësues-i/ja të jetë një monitorues-e i/e mirë i dokumenteve që përzgjidhen për portofolin.

c. Vetëvlerësimi

Ky lloj vlerësimi është gjykimi që secili nxënës jep për arritjet e tij. Vetëvlerësimi shpesh shërben si një plotësues i domosdoshëm i teknikave të vlerësimit, të bëra nga mësues-i/ja dhe nga provimet. Pika e fortë e vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është një faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxënësit e tyre. Duhet theksuar që vetëvlerësimi është më i vlefshëm dhe më objektiv nëse nxënësit i jepen kritere të sakta, mbi të cilat ai/ajo bën vetëvlerësimin e

punës së tij/saj p.sh.: mund t'i kërkohet nxënësit të hartojë një skedë vetëkorrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta dhe më pas, ai/ajo ta integrojë korrigjimin në veprimtarinë e kërkuar. Ky tip vlerësimi duhet të zërë një pjesë të konsiderueshme në ciklin fillor.

10 Materiale dhe burime mësimore

Për arritjen me sukses të kompetencave në fushën e TIK-ut dhe teknologjisë është e rëndësishme të përdoren materiale dhe burime mësimore që japin një informacion të kuptueshëm për moshën e nxënësit dhe që i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësi, shkathtësi, njohuri dhe qëndrime, që u nevojiten atyre për të mësuarin gjatë gjithë jetës. Njëri nga burimet e thjeshta mësimore që përdoret shpesh nga nxënësit dhe mësuesit, është teksti mësimor. Mirëpo me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe të shtimit të informacionit digjital, mësuesi duhet ta shohë tekstin më tepër si një burim nxitës, por jo të mjaftueshëm për të zhvilluar kompetencat kyçe tek nxënësit.

Mësuesit mund të bashkëpunojnë online me mësues të shkollave të tjera, për të gjetur burime të besueshme informacioni që u vijnë në ndihmë jo vetëm nxënësve për të zhvilluar aftësitë e tyre, por edhe mësuesve për të zhvilluar një qasje të re metodike. Nëpërmjet rritjes së shumëllojshmërisë së burimeve, ne nxisim më shumë nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik, krijues dhe problemzgjdhës gjatë procesit mësimor.

Disa nga burimet që mund të përdoren nga mësuesit për zhvillimin e orës mësimore, mund të jenë: bibliotekat elektronike, broshurat informuese apo ndërgjegjësuese, enciklopeditë, software elektronike në funksion të mësimdhënies/mësimnxënies, studimet shkencore me fokus tek teknologjia dhe TIK-u, etj...

Gjithashtu në bashkëpunim me nxënësit dhe shkollat mund të organizohen seminare të ndryshme mësimore dhe punimet më të mira të publikohen dhe t'u vihen në dispozicion të gjitha shkollave. Në ditët e sotme, ndodh shpesh që nxënësi të jetë një hap përpara mësuesit për sa i përket informacioneve elektronike, në këtë mënyrë mësuesit mund të krijojnë forume mësimore bashkë me nxënësit për të krijuar materiale në ndihmë të procesit mësimor.